



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E MBROJTJES

Drejtoria e Inspektimit të Përgjithshëm & Antikorrupsionit

Nr. 438/3 Prot

Tiranë më, 4/7 2016

Lënda : Kthim përgjigje

Drejtuar : Znj. Lindita ÇELA
Gazetare e Qendrës “BIRN Albania”

Bulevardi “Gjergj Fishta”
Kulla 5, Ap. 22
1001, TIRANË

E nderuar Znj. Çela

Në përgjigje të shkresës Tuaj, të datës 21.06.2016, “*Kërkesë informacioni*“, Ju informojmë se:

Autoriteti i Kontrollit Shtetëror të Eksporteve, në zbatim të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 43, datë 16.01.2008, ushtron kontrollin shtetëror mbi eksportin, importin, kalimin transit, transferimin dhe veprimtaritë ndërmjetësuese për mallrat ushtarake dhe mallrat e teknologjitë, me përdorim të dyfishtë.

Në këtë kuadër, gjatë ushtrimit të kësaj veprimtarie, qysh nga viti 2009, pranë AKSHE-s kanë aplikuar dhe janë pajisur me licenca eksporti për mallra ushtarake një sërë subjektsh (persona juridik, publik dhe privat).

Gjatë kësaj veprimtarie në rekordet e AKSHE-s rezulton se një ndër subjektet eksportuese është edhe kompania Bullgare “ALGUNS” ltd, për të cilën Ju informojmë specifikisht për sa vijon:

Si për të gjitha kompanitë e tjera të huaja, nga ana e subjektit aplikues pranë AKSHE-s është sjellë Licenca e Eksport/ Importit nr. 11.00-241-1, datë 14.05.2014, lëshuar nga autoritetet kompetente Bullgare, e cila i jep të drejtën kompanisë Bullgare “ALGUNS” ltd, që të realizoj eksport/importin për mallrat ushtarake dhe ato me përdorim të dyfishtë, e vlefshme deri më datë 14.05.2019.

Po ashtu, nga ana e AKSHE-s është kërkuar dhe marrë informacion nga Autoritetet Bullgare në lidhje me aktivitetin e kompanisë “ALGUNS” ltd,. Nëpërmjet email-it zyrtar, në datë 19.05.2016, Drejtori i Drejtorisë së Zyrës së Sigurisë dhe Tregtisë, në Ministrinë e Ekonomisë në Bullgari, ka konfirmuar:

1. *vërtetësinë e licencës së aktivitetit të kompanisë Bullgare “ALGUNS” ltd;*

2. subjekti para marrjes së licencës ka dorëzuar dokumentacionin mbi sigurinë e cila është parakusht për marrjen e licencës në shtetin Bullgar;
3. kompania "ALGUNS" ltd nuk është përfshirë në veprimtari kriminale.

Po ashtu, me shkresën nr. 931, datë 23.05.2016, Ambasada e Republikës së Bullgarisë në Shqipëri ka konfirmuar vlefshmërinë e licencës së kompanisë "ALGUNS" ltd, si dhe që kjo licencë është lëshuar në bazë të kontrolleve që janë kryer kompanisë për kriteret e besueshmërisë dhe stabilitetit ekonomik. Gjithashtu, Ambasada ka theksuar se Republika e Bullgarisë aplikon një prej standardeve më të larta në fushën e kontrollit të eksporteve dhe prodhimit të mallrave ushtarake.

Gjatë procesit të licencimit, AKSHE verifikon të gjithë dokumentacionin e nevojshëm dhe konform tyre pajis me licencë subjektet aplikuese, për të cilat në rastin e eksportit informon subjektet se mallrat e eksportuara nga Republika e Shqipërisë nuk mund të rieksporthen pa lejen e autoriteteve të shtetit përkatës dhe ndalon eksportin e këtyre mallrave për në vendet nën embargo të plotë apo të pjesshme.

Duke nisur nga shtatori i vitit 2013, me udhëzim të Ministrit të Mbrojtjes, Ministria e Mbrojtjes dhe strukturat e saj, nuk mund të shesin (eksportojnë), përveçse në vendet e Bashkimit Evropian dhe NATO-s (end-user). Gjithashtu, Ministria e Mbrojtjes dhe strukturat e saj ligjzbatuese, nuk mund të paragjykojnë sistemet dhe strukturat ligjzbatuese të vendeve anëtare të NATO-s dhe BE.

Për licencat e lëshuara nga AKSHE, në të cilat ka qenë e përfshirë kompania Bullgare "ALGUNS" ltd dhe për të gjitha rastet e tjera, nga ana e subjekteve aplikuese pas realizimit të eksportit paraqitet pranë AKSHE Certifikata e Mbërritje së Mallit në Destinacion. Për eksportet e realizuara janë sjellë Certifikatat e Mbërritje së Mallit në Destinacion (*Devivery Verification Certificate*).

Për informacion të mëtejshëm mund ti drejtoheni direkt AKSHE-s.

Duke ju falënderuar për mirëkuptimin.

DREJTORI

KAPITEN I RANGUT TË PARË ARTUR MEÇOLLARI

